


Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë deri shtator 2024

Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për periudhën janar shtator 2024 IHD arrijnë në 657.3 milion euro, rritje për 38.5 milion apo rreth 6.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Krahasuar me vitet paraprake kemi një ulje të trendit të rritjes vjetore.


Figura 1. Investimet e Huja Direket sipas viteve (miliona Euro) dhe rritja/ulja vjetore në %



Burimi: Banka Qendrore e Kosovë (BQK)

Sipas të dhënave janar shtator 2024, lidhur me aktivitetet ekonomike Investimet e huaja direkte vazhdojnë të dominohen kryesisht nga Aktivitetet e patundshmërisë me 71.4% dhe Aktivitete financiare dhe të sigurimit me 14.9% derisa pjesa e mbetur prej 13.7% janë aktivitetet tjera (prej tyre Ndërtimtari me 1.6%, Prodhim me 1.5%, Xehetaria dhe guroret me 1.4%, Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 1.3%, etj).

Figura 2. Investimet e Huaja Direket sipas viteve dhe aktiviteve ekonomike në %



Analizat sipas vendeve të origjinës kryesohen nga vendet e BE 27. Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas shteteve (neto), për periudhën janar shtator 2024 janë: nga Gjermania 20.8%, nga Zvicra 20.0%, nga SHBA 9.5%, nga Shqipëria 11.4%, nga Austria 7.0%, nga Britania 2.3% etj, si pjesëmarrjen në IDH e përgjithshme.

Figura 3. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shteteve dhe viteve në %

